



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA
KOMUNA E OBILIOIT-OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlaçna
Nr. 11-730
Br.

Data 30.08.2018
Datum

OBILIOI-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 9. Pika 1.4 të Udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL - për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), thërras mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Obiliqit - me dt.05.09.2018 (e mërkurë) në ora 11:00 në sallën e KK-së, me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Gjendja e sigurisë në Komunën e Obiliqit
4. Të ndryshme



Kryetari i KKSB

Xhafer Gashi

EKSTRAKT NGA PROCESVERBALI

I mbledhjes së III-të të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Komunën e Obiliqit, të mbajtur më 13.06.2018 në ora 10:00 , në sallën e KK-së.

Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë: Kryetari i Komunës-Xhafer Gashi, Komandanti i SP-Sejdi Zeqiri, përfaq. i FSK-major F.Fejzullahu, perf.i BIK-I.Hashani, përfaq.i komun.ortod. Nasipaliq Aleksander, përf.kom.serb.- Slavisha Jakovljeviq, përfaq.i komun.boshnjak-Lejla Boshnjak, drejtor i DMM-Arben Berisha, drejtori i DA -Agim Spahiu, përf.i Kësh.të prind.-Fatmir Bërbatovci, përf.kom.rom-Shaban Berisha, zyrtari i emergj.-Valon Berisha, Qendra Rinore-Zelushe Kelmendi, Eljesa Tërbunja-Handikos, EVSB-Sejdi Haxholli, OJQ "Aureola"- Sanije Graçevci, ZKKK- Sllavisha Agjaniq, Kryetar i K. Komunitete-Avdyl Mustafa, përfaq.i kom.malaz.-Jasmina Radanovic, zyrt.baraz.gjinor-Ganimete Aliu dhe koordinator i KKSBB - S. Hashani.

Mungoi: Kryetari i KLSP- sekt.I-re-Burim Gërguri (viz.zyrt.në SHBA)

Mbledhjen e udhëhoqi Kryesuesi i KKSBB-Xhafer Gashi, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se ka kuorum për të filluar mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Gjendja e sigurisë në Komunën e Obiliqit
4. Të ndryshme

Kryetari- Pasi i përshëndeti të pranishmit dhe para se të kalohet në r.d. kërkoji nga koordinatori i KKSBB-së ti drejtohet KBI - Obiliq me një shkresë dhe ti kërkojmë që të na përgjigjen lidhur me përfaqësuesin e tyre B.Mjekiqi, i cili që nga funksionimi i KKSBB-së nuk vie në mbledhje, apo të caktojnë ndonjë person tjetër për KKSBB, pasi që me vendim të KK-së, anëtarë i KKSBB-së është B.Mjekiqin.

Nënkyetari për komunitete-S.Jakovljeviq- Para se të kalohet në r.d, tha se nuk ka vërejtje në procesverbal por kërkoj nga kryetari të bëjë përpjekje në rritjen e ekzekutuesve gjegjësisht përkthyesve sepse administrata ka nevojë për përkthyes dhe njëherit t'u ndihmohet zyrtarit për përkthime dhe zyrtarëve tjerë që punojnë në përgatitjen e materialit për mbledhjet e KK-së, KPF-së dhe K.Komunitete, sepse janë të ngarkuar në përpilimin dhe përkthimin e materialeve.

Kryetari- tha se sot zyrtari i IT-së Lavdimi më ka njoftuar se sot do të vijnë përfaqësuesit nga Bashkimi Evropian për kontrollimin dhe rregullimin e zërimit.

Pas kësaj propozoi këtë r.d. cili u aprovua njëzëri.

I. Pika e parë e rendit të ditës.

Mungoi : Kryetari i KLSP- sekt.I-re-Burim Gërguri (viz.zyrt.në SHBA)

II. Pika e dytë e rendit të ditës-

Pasi nuk pat vërejtje nga të pranishmit njëzëri:

Aprovohen procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

III. Pika e tretë e rendit të ditës-

Komandanti i SP- S.Zeqiri - sa i përket situatës së sigurisë në komunën tonë mundemi të themi se është e qetë dhe relative, muajit te fundit i njoftoi të pranishmit me disa raste, si vijon: ne fshatin Milloshevë kemi bërë kontrollimin e një shtëpie ku një person është mëshehur gjatë dhe në këtë rast është vlerësuar se mundet te cenohet siguria e tij nga vet ai, ku si qëllim i tij ka qene me ju bashku edhe disa personave tjerë për të shkuan në luftë në Siri , dhe ne e kemi lokalizuar atë vend dhe e kemi bastisur shtëpinë ku kemi gjete disa armë pa leje dhe person është arrestuar dhe është ne mbajtje dhe mbetet gjykata ose prokuroria të jap vendimin për të .

Ne fshatin Mazgit, qytetarët janë te shqetësuar për arsyen se janë shtuar rastet e vjedhjeve, rastet janë shtuar edhe në zonën e KEK-ut, mirëpo personat e dyshuar janë arrestuar nga ana jonë. Rasti i fundit ne rajonin e Obiliqit ka qenë mes dy familjeve për një mexhë, ku familjet kanë qenë në konflikt për rrith pronës ku ka pasur edhe shkrepje te armës, dhe personat janë ftuar ne polici, por kemi edhe raste tjera që janë nxënë me substancë narkotike por njehërit e posedojmë edhe listën e poseduesve te substancave narkotike , lidhur me këtë rast kemi edhe te arrestuar disa persona.

Po ashtu si raste tjera i kemi pasur edhe ne shkollën e Milloshevës dhe Dardhishtës ku kanë marr nji CD -hark disk ku posedon te dhënat , por është këshilluar drejtori te mbyll shkollën. Në Dardhisht një person ka hapur lokalini pa dokumentacion valit dhe nuk ka marr pëlqim nga ne, ne atë vend është gjuar me arme, kemi gjetur armen dhe personi është ne mbajtje deri sa ka kaluar rasti ne prokurori.

Ne kemi një plan operativ edhe përkundër stafit te vogël, në këto vende si Plemetin, Babimofc dhe Palaj, qe vazhdimisht patrullat te monitorojnë për shkak qe kemi minoritetet dhe mund te themi qe kemi me pake vjedhje se muajt e tjerë.

Po ashtu kemi edhe plan operativ për muajin e Ramazanit d.m.th. për ditën e faljes se Bajramit, qe situata e sigurisë te jete e qete për qytetaret kur te falin Bajramin pasi qe edhe kryetari do te merr pjese ne faljen e bajramit. Kemi shqetësimë nga qytetaret lidhur me transportin publik ku janë 8 kompani qe gravitojnë ne komunën tone dhe e akuzojnë njeri tjetrin se organet komunale disa kompanive ju jasin përparsë se te tjerëve por kjo bie ne komptencë te inspektorit dhe çdo here do te asistojmë me kërkesën e inspektorit komunal.

Arben Berisha- ju falënderua komendantit me këto informata dhe tha se na banë edhe neve mu ndier mire.
Kryetari- Sa i përket çështjes të ngritjes të kapaciteteve në numër të zyrtarëve policorë, ne kemi pasur edhe një takim me drejtorin e policisë dhe me ministrin e punëve të brendshme që të rriten kapacitete në njerëz dhe në logistikë me qëllim që të i kryejmë shërbimet sa më mirë dhe jemi duke bere përpjekje qe stacioni policor i Obiliqit te rangohet ne kategorinë B.

IV. Të ndryshme-

Avdyl Mustafa -shtroj pyetje për ujësjellësin dhe pronën qe gjendet ne rrugën Sokoli- ne Plemetin.

Kryetari- tha se sa i përket qeshjes se ujit ne kemi diskutuar edhe me nënkyretarin S.Jakovljeviq, kam kërkuar nga drejtori i shërbimeve publike qe te merret me këtë çështje dhe javën tjetër do te përmbyll pas kontaktimit me drejtorinë e ujësjellësit. Ne rrugën Sokoli e ka marr ne shfrytëzim prej komunës pronën por për çdo parregullsi mund ta vendosim edhe ne kuvend.


S.Jakovljeviq-përfaqësuesit e komunitetit myslimanë e kane pasur muajin e Ramazanit dhe ne fund festën e Bajramit dhe ju dëshirojë te gjitha te mirat ndërsa komuniteti serb në fund te muajit e kane ditën e tyre te madhe Vidovdanin qe festohet me 28 Qershori dhe për këto festa duhet te kemi kujdese sepse nga ana e komendantit te policisë dëgjova se ju do te jeni në Xhami për faljen e Bajramit dhe policia do te përkujdeset rrith asaj dite dhe kështu i njëjtë kujdes duhet te vlej edhe për Vidovdanin sepse numri i madh vine prej

Serbisë qendrore edhe kështu, policia të jenë te gatshëm dhe te parandalojnë ndonjë indicet qe munde te ndodhin . Desha te theksoja se nuk dyshoj ne punën e komandantit dhe policisë se nuk dot kryejnë punët e veta profesionale por duhet te jene te kujdeshëm qe festat te kalojë sa me mire.

Komandanti- lidhur me festen e Bajramit është plani operativ është ne kuadër te stacionit policor i cili quhet "Festo me zemër, jo me arme " dhe do te implementohet prej ditës se nesërme, dhe mendoje qe në nivel lokal janë bërë përgatitjet e duhura qe te jete siguria ne nivel ndërsa sa i përket Vidovdanit , ne jemi ne hartim te planit operativ i cili kërkon personel ma të madh dhe do ketë karakter regional besoj qe do te kaloje mirë edhe këtë vit por edhe për ata qytetar qe do vijën për këtë festë nga Serbia, te vijën dinjitetshëm dhe te shkojnë ashtu dhe ne do te ju ofrojmë kushtet dhe mundësit që festa të shkojë sa më mirë dhe nuk do te lejojmë te prishin imazhin e festes . Ne do te sigurojmë rrugën nga Mitrovica deri ne Gazimestan dhe nuk do te lejojmë prishjen e imazhit te festes. Festa do te filloj prej 26 qershorit ne Graqanice dhe do te përfundoj me 28 qershor, ne Gazimestan. Ne jemi ne kërkim te disa pikave te zeza ne krahasim me vitin e kaluar ku jane evidentuar ne përgatitjen e planit operativ për këtë festë ende nuk është përfundimtare. Por Stacioni policor i Obiliqit, Mitrovicës dhe Graqanicës do te kenë barën kryesore për këtë manifestim.

Takimi përfundoji në ora 10:50.

Koordinatore-Procesmbajtës
S. Hashani



Kryesuesi i KKSB-së
Xhafer Gashi

